



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d dhe 17 shkronja k të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 3. pika 1.3 të Ligjit për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit nr. 03/L-164, nenit 18. shkronja k të Statutit të Komunës së Podujevës dhe nenit 4 të Memorandumit të bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Podujevës të datës 18 mars 2014, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2014, miratoi:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR NDARJEN E SHTËPIVE NË PRONËSI TË KOMUNËS NË LAGJEN E DËSHMORËVE NË FSHATIN BALLOC

Neni 1

Për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, familjeve banuese në lagjen e cekur, përkatësisht familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve të luftës së UÇK – së, viktimave civile, familjeve me anëtar me nevoja të veçanta dhe atyre në asistencë sociale, ngritet Komisioni në përbërje:

1. Avni Ajeti, kryesues, këshilltar i Kuvendit
2. Kadri Avdiu, anëtar, këshilltar i Kuvendit
3. Haki Rudari, anëtar, këshilltar i Kuvendit
4. Ruzhdi Dema, anëtar, Shërbimi civil i Komunës
5. Fadil Mulliqi, përfaqësues i Organizatave të dala nga Lufta e UÇK – së.

Në cilësinë e vëzhguesit, në punën e Komisionit, merr pjesë përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 2

Komisioni e bënë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të banimit në Lagjen e Dëshmorëve, bashkëpunon me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Strukturat e Komunës dhe me përfundimin e ndërtimit të shtëpive e bënë ndarjen e tyre.

Neni 3

Komisioni, në funksion të lirimit të hapësirës për ndërtim të shtëpive, varësisht prej sigurimit të mjeteve financiare nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, vendos për largimin e objekteve aktuale të banimit – kontejnerëve.

Neni 4

Kriteret e ndarjes, mënyra dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të shtëpive do të përcaktohen me akt të veçantë të Kuvendit.

Neni 5

Për punën e vet Komisioni i raporton Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-005-32384

**Podujevë,
10 prill 2014**



**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**